

**DOKUMENTAT STANDARDE
TË PROCEDURËS SË HAPUR PËR PUNË NDËRTIMORE**

OBJEKTI “NDËRTIM I SHTËPISË FAMILJE”

Projekti “**Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes
sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës**”

AID 10950”,

i bashkëfinancuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe

Zhvillim (AICS), si dhe i implementuar nga

Istituto Pace Sviluppo Innovazione ACLI

I. NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

Emri Acli Ipsia në Shqipëri
Adresa Rruga "Palokë Kurti", Nr.1, Shkodër
Tel/Fax +355(0)68 4072096
E-mail acliscutari@gmail.com

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion i pavarur

X

1.3 Lloji i Kontratave

Pune ndertimore

X

1.3 Përshkrim i shkurtër i kontratës

- Fondi limit: 15.166.166,00 pa TVSH ose 18.200.000,00 me TVSH
- Burimi i Financimit: Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS)
- Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Afati i realizimit të ndertimit do të jetë brenda 4 (kater) muaj nga momenti i lidhjes së kontratës me objekt "Ndertimi i Shtëpisë Familje".
- Objekti i kontratës: "Ndertimi i Shtëpisë Familje".

Seksioni 2 Procedura

2.1 Lloji i procedurës:

Faza e pare: shprehje interesi per pjesmarrje; faza e dyte: ftese shoqerive qe kane shprehur interesin ne fazen e pare.

2.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht më e favorshme

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

2.3 Afati kohor për kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 25/06/2018 Ora:12:00

Vendi: Acli Ipsia ne Shqiperi, Rr. Paloke Kurti, 1, 4001, Shkoder

2.4 Afati kohor për hapjen e kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 25/06/2018 Ora:12:00

Vendi: Acli Ipsia ne Shqiperi, Rr. Paloke Kurti, 1, 4001, Shkoder

2.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: **150 dite** (e shprehur në ditë)

2.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip **X** Anglisht **d**

6. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

25.06.2018, ora 12.00. Vendi: Acli Ipsia ne Shqiperi, Rr. Paloke Kurti, 1- 400, Shkoder

7. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

25.06.2018, ora 12.00. Vendi: Acli Ipsia ne Shqiperi, Rr. Paloke Kurti, 1- 400, Shkoder

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Operatorët ekonomike duhet të paraqesin ofertat e tyre sipas skemes së mëposhtme:

Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për ekzekutimin e punëve; Nr. e Njoftimit. “Ndertimi i Shtëpise Familje” .

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA 25.06/2018, ora 12.00

Brenda zarfit të mesiperm duhet të futen tre zarfa, secili i mbyllur, firmosur dhe vulosur, si me poshte:

Zarfi i pare (me titull **Zarfi A - Dokumentat e Parakualifikimit**) duhet të përfshijë, ndër të tjera, dokumentat e parakualifikimit si me poshte:

- a. CV e kompanisë (me dëshmi të përvojës së kompanisë në kryerjen e punëve të ngjashme);
- b. Kopja e regjistrimit dhe licencës së shoqërisë dhe kopje e licensave të personelit teknik;
- c. Kopje e certifikatave ISO (ISO 9001, 14001, 50001, SA 8000, BS OHSAS 18001);
- d. Dëshmia e pajisjeve të marra me qira ose në pronësi;
- e. Kopje e statusit të pageses së taksave leshuar nga autoritetet tatimore. Konfirmim i Autoriteteve Tatimore për mospasjen e detyrimeve për 6 muajt e fundit;
- f. Kopje të Bilancit të kompanisë për tre vitet e fundit, i cili duhet të jetë i barabartë ose më i madh se trefishi i fondit limit (bilancet duhet të jenë të firmosura, vulosura dhe protokolluara nga autoritetet tatimore);
- g. Dokument nga banka që verteton situatën e shëndoshe financiare të kompanisë.
- h. Garancinë e sigurimit të ofertes me vlerë 2 % të fondit limit.

Mungesa e njerit nga dokumentat e sipër përmendura nuk kupton skualifikimit të Ofertuesit nga tenderi, si rrjedhojë edhe moshapjen e Zarfave B dhe C.

Zarfi i dytë (me titull **Zarfi B – Oferta Teknike**) duhet të përfshijë dokumentat e Ofertes Teknike si me poshte:

1. Një raport teknik mbi planifikimin e kantierit që të përfshijë: i) optimizimin e punës në kantier në lidhje me zhvillim normal të aktiviteteve; ii) planin dhe sekuencën e punimeve;
2. Në vazhdim të pikës 1: një kronogram program të detajuar të punimeve;
3. CV të stafit teknik drejt për se derejt të përfshirë në punime;
4. Një raport teknik mbi cilësinë e materialeve të përdorura dhe përmirësimeve potenciale të propozuara;

Zarfi i tretë (me titull **Zarfi C – Oferta Financiare**) duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtme:

1. Preventivin e plotësuar me cmimet dhe vlefat përkatëse (në rast mospërputhje midis subtotalit të zerit përkatës dhe cmimit për njësi, ky I fundit do të merret për bazë – preventivi bashkelidhur;

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertes duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore,

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfë që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM OFERTE”** ose **“TËRHEQJE OFERTE”**.

Përlllogaritja e ofertës teknike dhe ekonomike

Vleresimi do të kryhet sipas metodës së ofertës ekonomike me të favorshme (*offerta economicamente più vantaggiosa - best value for money*), ku Oferta Teknike do të vlerësohet me një maksimum prej 70 pikësh dhe Oferta Ekonomike me një maksimum prej 30 pikësh, sipas kriterëve të mëposhtme:

1. Kapaciteti, resurset, kompetencat dhe pervoja e Ofertuesit (ne lidhje me pune te ngjashme): **maksimumi 20 pike;**
2. Metodologjia, Qasja dhe Plani i Zbatimit (vleresuar mbi pikat 1 dhe 2 te Ofertes Teknike): **maksimumi 20 pike;**
3. Cilesia e materialeve te perdorura dhe permiresime potenciale te propozuara (vleresuar mbi piken 4 te Ofertes Teknike): **maksimumi 20 pike;**
4. Stafi Teknik i propozuar (bazuar mbi piken 3 te Ofertes Teknike): **maksimumi 10 pike;**

5. Oferta ekonomike: 30 pike

Oferta ekonomike (bazuar ne fondin limit)

Metoda per perlloraritjen e pikeve te Ofertes ekonomike

Vleresimi i pikeve per secilen Oferte ekonomike te paraqitur do te behet sipas kritereve te meposhtme:

$P(\text{Piket}) = [\sqrt{P_{\min}/P_{\text{of}}}] \times 30$; ose = rrenja katrore e cmimit minimal te ofruar/cmimin e ofruar *30

P_{\min} = cmimi minimal I ofruar

P_{of} = Cmimi i ofruar

Oferta anormalisht te uleta

Perpara aplikimit te formules se mesiperme per percaktimin e pikeve te Ofertes Ekonomike, do te konsiderohen oferta anormalisht te uleta ato oferta sipas formules se meposhtme:

B_a = Fondi limit

O = Oferta ekonomike

M_O = Mesatarja e ofertave ekonomike

n = Numri i ofertave

R_a = Ulja e lejuar

$$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n/n;$$

$[B_a - M_O]$ = Diferenca midis Ofertes ekonomike dhe mesatares se ofertave ekonomike;

$$R_a = [B_a - M_O] + 1/5 \times [B_a - M_O];$$

$$[B_a - O] \leq R_a$$

Diferenca midis fondit limit (B_a) and the Ofertes ekonomike te marre ne shqyrtim (O) duhet te jete me e vogel ose e barabarte me R_a . Ne rast se oferta ekonomike e marre ne shqyrtim nuk permbush kriterin e mesiperme ajo do te quhet anormalisht e ulet dhe si e tille do te skualifikohet.

Oferta ekonomike ka nje vlere maksimale prej 30 pikesh.

Piket totale do te percaktohen si me poshte:

Piket totale = Oferta Teknike + Oferta Ekonomike.

Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar punët që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre për “kontratat me çelsa në dore” dhe “çmimet fikse” për kontratat e punimeve me matje .

Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH-ne. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Ofertuesi duhet të shënojë në preventiv çmimet për çdo zë punimi dhe çmimin total të ofertës të të gjitha punëve, pa TVSH. Vlera e TVSH-se, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.

Përveç kur Dokumentat e Tenderit e parashikojnë ndryshe, çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor si e papranueshme.

Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet nuk janë përcaktuar çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara ato janë objekt i ndryshimit pas një Mini-konkursi në mes të palëve në marrëveshjen kuadër.

Sigurimi i Ofertës kur kërkohet duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Për sa kohë nuk ka skaduar afati kohor për vlefshmërinë e ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta

nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së.

Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e pajis njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, sipas shëmbujve të mëposhtme:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,
- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojnë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

Nënshkrimi i Kontratës

Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit.

Sigurimi i kontratës

Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës.

Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së kontratës.

Formulari i Sigurimit të Kontratës, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare,

b) garanci sigurimi.

III. KRITERET TE PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Sqarim: Dokumentacioni i pershkruar ne seksionin II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË eshte i detyrueshem.

Pervec tyre kriteret e poshteshenuara, qe nuk jane perfshire ne seksionin II, duhen plotesuar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
 - b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kriteret (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte;*
- b. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike;*
- c. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit;*
- ç. *Përshkrimin e Ofertës;*
- dh. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve;*
- e. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

1 *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1)).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ne lidhje me vlerësimin e gjendjes ekonomike e financiare te kandidatit/ofertuesi duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme:

1. *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete kryer xhiro totale per vitet 2015, 2016 dhe 2017, te pakten sa trefishi i fondit limit, ose thene ndryshe ne ne nje vlere totale prej 54.600.000 Leke*
2. Ne plotesimin e kesaj pike operatori ekonomik duhet te paraqese:
 - a. Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave per xhiron e realizuar gjate viteve te siperpermendura.
 - b. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese kopje të bilanceve, te certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2015, 2016 dhe 2017*
 - c. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate te gjendjes financiare nga nje ose me shume banka sa 10% e vleres se kontrates qe prokurohet. Ky dokument duhet te jete leshuar jo me pare se 5 dite nga data e hapjes se ofertave.*

3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike (perfshire muajin Prill 2018) te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i rregjistruar ne Shqiperi*

Mosshlyerja e detyrimeve te energjise elektrike perben shkak per skualifikimin e operatorit ekonomik, pervec rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara te energjise elektrike, te konfirmuara ne vertetimin e leshuar nga furnizuesi, jane ne proces ankimimi ne Gjykate.

4. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje dokument qe verteton se (Subjekti juaj) ka paguar taksat vendore per vitin 2017 leshuar nga administrata lokale per te gjitha vendet ku ushtron aktivitet shoqeria sipas ekstraktit te QKR*

2.3 Kapaciteti teknik:

- 1) *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë përvije të suksesshme në ekzekutimin të pakten:*

a. *Punë të ngjashme për një objekt të vetme në një vlerë prej **9.100.000 Leke**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të tij;*

ose

b. *Punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të tij, të jete në një vlerë prej **54.600.000 Leke***

- 2) Lidhur me këtë pikë ofertuesi të paraqese:

Formularin e vleresimit, shoqëruar me:

Kontrate sipermarrjet

Situacionin përfundimtar

Akt-kolaudim

Certifikaten e marrjes në dorezim

Ne rastin e përvijes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, ofertuesi do të vërtetojë këtë punë duke paraqitur Formularin e vleresimit, shoqëruar me:

Kontrate.

Situacionin përfundimtar.

Akt kolaudimi objekti.

Çertifikaten e marrjes në dorezim të objektit.

Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

- 3) *Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me licënsë profesionale leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë minimumi kategorite e mëposhtme. (Nese operatori eshte i pajisur me licenca profesionale qe përmbajne kategori me të larta –niveli B, C, D nënkupton kompani me eksperience me të mire)*

> N.P-2

Ndërtime civile dhe industriale.

Niveli i shoqërisë

A

>	N.P- 3	Rikonstuksion dhe mirembajtje godinash.	Niveli i shoqerise	A
>	N.P – 11	Ndertime per N/Stacionet, kabinat...	Niveli i shoqerise	A
➤	N.S. 1	Punime per prishjen e ndertimeve	Niveli shoqerise	A
➤	N.S. 2	Impiante hidrosanitare...	Niveli shoqerise	A
➤	N.S. 4	Punime rifiniture...	Niveli shoqerise	A
➤	N.S. 12	Impiante Teknologjik...	Niveli i shoqerise	A
➤	N.S. 14	Impiante te brendshme, elektrike..	Niveli shoqerise	A
➤	N.S 18	Punime gjeodezike	Niveli shoqerise	A

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

4)

Operatori ekonomik ofertues duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve për realizimin dhe zbatimin e kontrates. Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim te leshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetstore ne te cilin te jete i percaktuar numri i punonjesve te siguruar per secilen nga periudhat e mesiperme, shoqeruar me listepagesat perkatese E-Sig, per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetstore.

5) Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar te pakten

1 inxhinier ndërtimi

1 inxhinier elektrik

1 inxhinier mekanik

1 inxhinier topograf

Inxhinieret duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: a) Kontratat individuale te punes, dhe b) Diplomat, dhe c) CV-te, dhe d) Librezen e Punes, te inxhinierëve te mesiperme.

7. Operatori Ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme, si me poshte:

- ISO 9001:2008 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”,
- ISO 14001:2004 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit”
- BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”
- ISO 50001:2011 mbi “Sistemet e menaxhimit te energjise”,
- ISO SA 8000:2014 – SOCIAL ACCOUNTABILITY MANAGEMENT SYSTEM

6) Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij 1 nje mjek te punesuar ne kompani, ne baze te paragrafit 12/2 te VKM Nr. 692, date 13.12.2001 ”Per masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune”, i ndryshuar me VKM nr. 742 date 6.11.2013. Kjo te vertetohet me deshmine, diplomen, kontraten e punes dhe formularet Esig

7) Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e meposhtme per kryerjen e punimeve, me qellim realizimin e objektit te prokurimit:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Kamion ≥ 5 ton(ngarkesa)	1 cope
2	Kamion deri ne3 ton(ngarkesa)	1 cope
3	Gjenerator per kantier 2-3 KW	1 cope
4	Betoniere	1 cope
5	Autobot uji minimalisht 5 ton (ngarkesa)	1 cope
6	Rrjet per mbrojtje nga suvatimet	400 m ²
7	Skela	400 m ²
8	Armature	200 m ²
9	Matrapik	1 cope
10	Vinç karrel	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Listen e mjeteve.
 - ii. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit taksat, si edhe leja e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tretë.
 - iii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
 - iv. Për mjetet e marra me qira/furnizim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit ku të specifikohet afati i kontratës, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit taksat,si edhe lejen e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tretë.
 - v. **Për çdo mjet të paraqiten fotot përkatëse për identifikimin e mjetit.**
8. *Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë deklaratë që makineritë e kerkuara, nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu ne deklarate duhet te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi.*
 9. *Operatori ekonomik ofertues nuk duhet te kete detyrimet e papaguara vendore, detyrime te ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrimet e ngarkuar nga organe te tjera.*
 10. *Autoriteti kontraktor do te realizoje kontrolle te cilesise se punimeve per objektet e realizuara nga operatoret ekonomik*
 11. *Nuk lejohet nenkontraktimi i punimeve.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Periudha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates).

